

SHKOLLA PËR INTEGRIME EVROPIANE PËR PLANIFIKIM DHE ZHVILLIM URBAN

EC Ma Ndryshe me përkrahje të Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS) sivjet do të nis organizimin e Shkollës për Integritime Evropiane për Planifikim dhe Zhvillim Urban. Qëllimi kryesor i ligjëratave në tri module në kuadër të kësaj Shkollë është ngritja e nivelit të njohurisë tek pjesëmarrësit në çështjet dhe praktikët evropiane lidhur me planifikimin dhe zhvillimin urban, në mënyrë që më pastaj ata ti përdorin njohuritë e fituara në ambientin e tyre të punës dhe ti transmetojnë tutje. Në këtë mënyrë do të jepej një kontribut më domethënës në integritet evropiane, si nga përfaqësuesit e institucioneve lokale e qendrore, por edhe hisedarët tjerë nga komuniteti i profesionistëve, OJO-të, studentë alumni të Shkollës Evropiane, studentët e arkitekturës, sociologjisë, etj.

Modulet që do të organizohen nga EC Ma Ndryshe gjatë vitit 2015 janë:

Moduli 1. Urbanizimi dhe çështjet e menaxhimit urban, 25-27 shtator 2015, Durrës-Shqipëri

Ky modul trajton trendët e urbanizimit në kontekstin global në përgjithësi dhe në kontekstin kosovar në veçanti. Gjithashtu nënvizon sfidat e menaxhimit urban në botën bashkëkohore. Moduli diskuton sfidat që paraqiten para qeverive lokale dhe mundohet që t'i identifikojë fushat për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike.

Përmbajtja

- Përshkrimi i rritjes së urbanizimit në kontekstin global dhe lokal,
- Listimi i sfidave të urbanizimit dhe menaxhimit urban,
- Aplikimi i strategjive për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të qeverive lokale për ofrimin e shërbimeve publike

Moduli 2. Trashëgimia kulturore dhe planifikimi urban, 23-25 tetor, Prevallë-Kosovë

Ky modul ofron kuptim mbi rolin e trashëgimisë kulturore për regjenerimin urban dhe territorial, duke përfshirë politikët strategjike që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore, duke i përshkruar dhe ilustruar mënyrat dhe fazat e integritit të trashëgimisë kulturore në strategjikë lokale dhe rajonale të zhvillimit.

Përmbajtja

- Planifikimi urban si çështje e balancimit të mbrojtjes, regjenerimit dhe ndryshimit të mjedisit fizik, social dhe ekonomik,
- Roli i dokumenteve strategjike për menaxhimin e trashëgimisë kulturore,
- Perspektiva e qartë mbi relacionin ndërmjet menaxhimit të trashëgimisë kulturore dhe mbrojtjes së peizazhit/ Trashëgimia kulturore dhe mundësitë dhe sfidat e zhvillimit lokal,
- Kontributi i regjenerimit urban të bazuar në trashëgimi në politikët regjionale të BE-së

Moduli 3. Pjesëmarrja Publike në Planifikim Hapësinor, 20-23 nëntor, Ohër-Maqedoni

Moduli promovon pjesëmarrjen e publikut dhe qasjen e integritit të perspektivës gjinore në proceset praktike të planifikimit hapësinor, duke i përshkruar dhe ilustruar mënyrat dhe fazat e ndryshme për të përfshirë temat e perspektivës politike dhe operacionale.

Përmbajtja

- Menaxhimi i proceseve planifikuese me pjesëmarrje dhe gjithëpërfshirje,
- Korniza konceptuale dhe ligjore për proceset e planifikimit me pjesëmarrje dhe gjithëpërfshirje,
- Qasja praktike hap-pas-hapi për planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve me pjesëmarrje të publikut,
- Integrimi i perspektivës së pjesëmarrjes publike dhe gjinore,
- Hapat e përgjithshëm për pjesëmarrje publike.

Pjesëmarrësit

Modulet janë përgatitur për t'i plotësuar nevojat e pjesëmarrësve në fushat përkatëse dhe do të udhëhiqen nga ligjërues nga Kosovë dhe të jashtëm. Vijues të Shkollës do të jenë përfaqësues të gjashtë grupeve të ndryshme të institucioneve: qeveri qendrore, komunat, organizatat e shoqërisë civile, mediat, byrotë projektuese dhe studentët e Universitetit të Prishtinës.

Për të qenë pjesë e Shkollës, kandidati duhet:

- të jetë i angazhuar në njërin prej drejtimeve ku fokusohet shkolla,
- të ketë njohuri për zhvillimin dhe planifikimin urban,
- të jetë njohës i gjuhës angleze (meqë ligjëratat do të jenë edhe në gjuhën angleze),
- të ketë aftësi komunikimi dhe pune në grupe, si dhe
- të jetë i përkushtuar për t'i ndjekur të gjitha modulet e Shkollës.